



REPUBLIKA E KOSOVËS
BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS
Islamic Community of Kosova
KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME NË VUSHTRRI



Rr: "Mic Sokoli", Vushtrri, Kosovë
Tel & fax: +381/ 028 571 213

www.kbi-vushtrri.com
kbi-vushtrri@yahoo.com

Nr. Protok. **97/2011** Data: **28/02/2011**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

R A P O R T

PËR PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË VUSHTRRI PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2010.

I. Vështrim i përgjithshëm

Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri është institucioni i vetëm fetar islam në komunën tonë që zyrtarisht merret me organizimin e jetës dhe aktiviteteve fetare. Me një rrjet të shtrirë në qytet dhe në të gjitha fshatrat, (përfshirë fshatrat ku janë pakicat serbe e që i përkasin komunitetit krishterë-ortodoks), KBI arrin të mbulojë çdo aktivitet dhe shërbim fetar. Për këtë sukses, pas ndihmës së Allahut të Madhëruar, i detyrohemi edhe punës kolektive, unitetit dhe mirëkuptimit që, thënë me modestinë më të madhe, është ikonë e këtij institucioni fetar.

Të thirrur që interesi i Këshillit (lexo: fesë) të vihet para interesave individuale, KBI ka qenë dhe vazhdon të jetë gjithnjë në gjurmim dhe eksplorim të metodave dhe mundësive që institucioni ynë fetar të forcohet sa më shumë, dhe mu për këtë në vazhdimësi ka diskutuar e më pas ka miratuar rregulla për mbarëvajtjen sa më të mirë të veprimtarisë fetare dhe administrative ndërsa shërbimet, përveç ditëve dhe orarit të punës, organizohen edhe me kujdestari. Si risi ndoshta që ia vlen të veçohen për vitin që lamë pas është rregullorja e institucionalizimit të të gjitha shërbimeve fetar, në këtë rast edhe atyre vullnetare, me të cilat këtu kemi për qëllim *mevludet dhe qelimet* si dhe *veshja e uniformës fetare*, për çka KBI paraprakisht ka pajisur të gjithë imamët dhe

administratën me to. Vlen të theksohet se për finalizim të këtyre rregullave, debati me transparencën më të madhe ka qenë i hapur për gjatë gjithë pjesës së dytë të vitit 2010, dhe imamët, qoftë në mbledhjet mujore, qoftë edhe në mbledhje të veçanta, siç ishte ajo e datës 3/6/2010, e organizuar enkas me imamët e qytetit.

KBI traditën e mbledhjeve mujore me imamë e vazhdoi edhe gjatë vitit 2010. Ndoshta karakteristika që vlen të theksohet më së shumti këtu, krahas transparencës për diskutime që përmendëm sipër, është edhe elementi relaksues i tyre gjatë kohës verore. KBI zgjodhi ambiente të hapura ku pas diskutimeve organizonte edhe lojëra sportive ndërmjet imamëve. Me qëllim të tubimit sa më të shpeshtë me imamë dhe takimeve sa më miqësore, Kryetari morri iniciativën dhe për çdo të premtë organizohen takime sportive me imamë në fusha të caktuara.

Viti 2010 e përmbyll më këto mbledhje e takime:

Me imamë	Me anëtarë të këshillit	Të ndryshme
11 (nëntë)	4 (katër)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ 1 (një) mbledhje është mbajtur vetëm me imamët e qytetit, dhe ▪ 1 (një) mbledhje është mbajtur me përfaqësuesit e Kryesisë me administratën dhe imamët e KBI-së, dhe këtë për hire të ardhjes së muajit Ramazan

Mbledhjet mujore me imamë nuk kanë karakter vendimmarrës. Ato organizohen me qëllim që imamët të njihen me ecuritë mujore të punëve të Këshillit si dhe të debatohen tema që janë me interes për KBI-në. Sa për shembull, në njërin prej tyre, respektivisht në mbledhjen e datës 1/6/2010, qe propozuar që mbledhja vijuese të fokusohet në diskutime për çështjen e *talkinit* dhe *mesteve mbi çorapë*.

Ndërsa mbledhjet me anëtarët e Këshillit kanë karakter tjetër. Në to fillimisht lexohet procesverbali i mbledhjes së kaluar, i cili më pas, pas vërejtjeve eventuale, miratohet dhe i njëjti i dërgohet Kryesisë. Debatohen çështje madhore, merren vendime me interes dhe shqyrtohen kërkesa dhe ankesa të ndryshme. Mbledhjet me anëtarët e Këshillit mbahen sipas nevojës por jo më pak sa një herë në tre muaj.

II. Jeta fetare

KBI, si përgjegjëse e jetës fetare për komunën e Vushtrrisë, aktivitetet e saja i ka të shtrira në intervale kohore të ndryshme: ditore, javore dhe vjetore apo pesë kohët e namazit, xhumanë dhe teravitë. Për këtë imamët pajisen në fillim të çdo muaji me tabelën evidentuese të përmbushjes së detyrave të tyre, të cilën në fund të muajit janë të detyruar ta sjellin në Këshill për tu paguar më pas sipas saj. Me qëllim të një mbikëqyrje sa më të madhe, Kryeimami ka vëzhguar kohë pas kohe punën e imamëve edhe prej së afërmi, ani pse kjo do një seriozitet edhe më të madh.

KBI-ja në Vushtri, me gjithë shkatërrimet e xhamive dhe objekteve fetare që pati në luftën e fundit, arriti një rekord në ndërtimin, riparimin dhe adaptimin e xhamive dhe objekteve fetare, madje në vitin 2010 në gjirin e vet futi edhe Xhaminë e f.sh. Beçiq, kështu që tani kur përpilohet ky raport, KBI-ja numëron këtë shifër xhamish:

Në qytet	Në fshatra	Në ndërtim e sipër
7	20	4 (Në Bukosh, Pasomë, Rrafshmir dhe Pestovë)
Vërejtje: Nga shifra e xhamive në fshatra, një rezulton të jetë montazhe, derisa në f.sh. Sllatinë figuron një montazhe tjetër dhe në Novolan një mesxhid por që shërbejnë vetëm për Ramazan ndaj edhe nuk janë llogaritur në kuadër të xhamive.		

KBI vazhdimisht ka qenë në hulumtim të donacioneve për ndërtim të Xhamive aty ku ka nevojë, apo për ndërtim të anekseve ose riparimeve eventuale. Për vitin e kaluar vlen të theksohet fitimi i donacionit për ndërtimin e Xhamisë në f.sh. Lummadh, për ç'gjë KBI falënderon shumë Imamin Islam Caka, falë mundit të të cilit Allahu na gëzoi me atë donacion. Në xhamitë e sipërpërmendura falja e namazeve bëhet siç figuron më poshtë:

5 kohë	3 kohë	2 kohë	Xhumaja	Teravitë
15	4	2	6	2

Aktivitete fetare të KBI nuk përkufizohen vetëm në këto që do t'i quaja edhe si obligime, por shfrytëzohen rastet dhe për të shënuar ndonjë datë të rëndësishme fetare, siç janë Mevludi dhe Israja dhe Miraxhi, organizohen manifestime përkatëse. Mevludi pati fatin më të mirë ngase u organizuan tri manifestime të ndryshme për të në Xhaminë Shejh Zaid, në Xhaminë Martirët dhe në Shtëpinë e Kulturës në Vushtri. Ky i fundit u organizua në bashkëpunim me Fondacionin

Sfera dhe M.M. Alauddin, paralelen në Prizren. E aktivitete fetare për gjininë femërore i organizon dhe mban rregullisht Ligjëruesja e KBI-së, motra Lumnije Zeqiri, e cila krahas aktiviteti të rregullt ka mbajtur edhe tribuna, siç ishte rasti me tribunën e organizuar në bashkëpunim me Depart. E Grave pranë Kryesisë para Ramazanit.

KBI-ja në radhët e veta numëron një staf bukur të gjerë dhe me përgatitje profesionale të kënaqshme. Në vitin 2010 ka patur të punësuar 27 imamë (dy prej të cilëve me marrëveshje në Pantinë dhe Beçiq) dhe 1 muezzin në qytet. Ndërsa në kuadër të administratës, duke llogaritur këtu edhe ligjëruesen për femra, ka numëruar gjithsej 8 veta. Kështu, numri i atyre që realizojnë të ardhura mujore nga ky këshill është 36 duke llogaritur edhe 3 pensionist sa pati KBI-ja për vitin 2010. Kompensimi material mujor për imamët është në këtë mënyrë:

- Marrëveshje: 100 €
- Katër xhumatë (me kontratë pune por me dallim kualifikimi): 150 – 165 €.
- Për çdo kohë namazi vlera shtohet 10 %.

Ndërsa për mësimbesim imamët stimulohen me të ardhura shtesë siç është sqaruar më poshtë:

- 6 herë gjatë javës= 30 €.
- 4 herë gjatë javës = 20 €.
- 2 herë gjatë javës = 10 €.

Aktiviteti fetar i KBI natyrisht se nuk mbaron me kaq. KBI tash e disa vite ka edhe librarinë, e cila luan një rol të madh në pajisjen e muslimanëve me dituri. Këtë e vërteton më së miri numri i lexuesve të rregullte që nga dita në ditë shtohet. Ndoshta kjo ka bërë që Këshilli ta freskojë kohë pas kohe librarinë me tituj të ri, sidomos në kohën e panairëve të librit. Më konkretisht, në vitin 2010 libraria e Këshillit është pasuruar me 73 tituj me 159 ekzemplarë; 56 tituj janë blerë ndërsa të tjerët janë dhuruar nga shtëpi botuese dhe individ te ndryshëm. Janë dhënë në lexim 670 libra ndërsa numri i lexuesve të rinj ka qenë 56, koincidence me numrin e titujve të blerë. Le të shpresojmë se me shtimin e titujve do të shtohen edhe lexuesit e rinj! Përveç kësaj, Këshilli vazhdimisht pranon literaturën fetare nga Kryesia dhe bën distribuimin e saj, qofshin ato mujore, siç është Dituria islame, apo edhe në periudha tjera, siç është Edukata islame tremujore apo edhe Takvimi vjetor. Ne kuadër të kësaj përfshihet edhe literatura tjetër e botuar nga Kryesia.

Aktivitetet fetare sigurisht se kane arritur këtë sukses falë edhe kontributit të Mual-limit, Sadik ef. Hasanit, i cili, ani pse ende vazhdon të jetë pa detyra të caktuara pune, gjithnjë është përkrahë tërë

atyre që duan ndihmën e tij. Këtë e dëshmon më së miri raporti i tij vjetor. Aktivitete tjera fetare, vullnetare, janë bere edhe nga Imamët Agim Rrahimi dhe Jeton Bilalli, te cilët gjate verës kane organizuar një kamping veror ku kane mbajtur ligjërata për te rinj.

KBI tash e disa vite ka edhe faqen e saj në internet, e cila freskohet me materiale kohë pas kohe. Fatkeqësisht participimi nga imamët dhe të tjerët është zero andaj i propozoj Këshillit të bëjë trysni mbi imamë që faqja të pasurohet edhe më tepër, sidomos tash në këtë kohë kur një nga format shumë të suksesshme të Davetit është edhe kjo elektronike.

KBI aktivitetet fetare i ka me intensive dhe më të larmishme në Muajin e Madhëruar të Ramazanit. Krahas ligjëratave ditore të imamëve para namazit të teravive, organizohen edhe ato të rregulltat në Xhaminë e madhe, që vitin e kaluar janë mbajtur kryesisht nga Imami Bedri Halili. Mukabeleja është mbajtur nga Muezzini Rexhep Gjyshinca ndërsa emisionet në Radio janë organizuar nga Kryeimami dhe këtë për çdo ditë para iftarit. Është organizuar edhe falja e namazit të natës në xhamitë Shejh Zaid, Gazi Ali Beg dhe Maxhunaj derisa I'tikafi është mbajtur ne dy xhamitë e para të përmendura dhe nga vet Imami i f.sh. Lummadh, Jeton Bilalli.

Edhe këtë vit KBI-në e kanë vizituar ekipi i Ramazanit të Kryesisë ndërsa vet Këshilli për të qenë më afër xhematit, tash e dy vite ka angazhuar edhe administratën, të cilët të ndarë në grupe dalin dhe vizitojnë xhamitë. Fale ndihmës së organizatave *Human Appeal International* dhe Jedu'l Ihsan dhe Imamëve Behar Dushi dhe Islam Caka organizohen edhe iftare të përbashkëta, iftare me struktura të ndryshme nga komuna jonë, iftare me Kryesinë, iftare në xhami të Këshillit të organizuara nga Imamët si dhe organizohet rregullisht falja e Bajrameve në Palestrën Sportive dhe pritja për urime në Sallën e Këshillit.

Aktivitet tjetër me karakter human me te cilin tash e sa kohe identifikohet KBI është edhe shpërndarja e mishit të kurbanëve.

KBI kete vit shenoi rekord edhe ne organizimin e Haxhit. Shifra e haxhilerëve nga komuna jone me organizimin te KBI-së ishte 57 veta.

III. Organizimi dhe disiplina ne pune

Rregullorja mbi Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Detyrave ka qenë mbështetje ligjore e mbarëvajtjeve të punëve të Këshillit edhe pse, për shkak të ruajtjes së unitetit më tepër është anuar në ndërgjegjësimit dhe përgjegjësi shpirtërore. Megjithatë, administrata mbikëqyret nga një tabele evidentuese e daljes në orar të punës, e cila me pas, në fund të muajit llogaritet dhe i dërgohet Kryetarit për nënshkrim. Tash në fund të vitit është bërë edhe llogaritja përfundimtare, gjë të cilën mund ta shihni në shtojcën e këtij raporti.

IV. Burimet financiare të KBI-së

KBI-ja si njësi e Bashkësisë Islame të R. së Kosovës është joqeveritare, që si pasojë ka financimin privat. Ajo nuk gëzon asnjë të mirë materiale nga shteti kështu që vet angazhohet nga pasuria që posedon të sigurojë të ardhurat mujore të punëtorëve të saj. Burimet kryesisht përqendrohen në:

- Pagimin e anëtarësisë vjetore, që është realizuar shumë suksesshëm.
- Qiratë e dyqaneve, të cilat ndonëse me pak vështirësi, janë realizuar mirë. Kemi ndërmarrë të gjitha hapat e ligjshëm, qoftë nëpërmjet konsultave, qoftë nëpërmjet gjykatës kur nuk mund të gjejmë mirëkuptim. Ne shtojcë keni një tabelë të lëndëve që për momentin vazhdojnë të presin zgjidhje në gjykatë. Keni po kështu edhe gjendjen e lokaleve për vitin 2010 dhe gjendjen e tanishme për këtë vit (2011).
- Dhënia e tokës, gjithsej 7 ha, me qira vjetore. Në shtojcë keni listën e tokës.
- Qiraja (simbolike) e banesave. Në shtojcë keni listën e banesave.
- Shërbimet e varrimit.
- Taksat tjera administrative.

Vlen të theksohet se KBI-ja ka angazhuar inkasantë për anëtarësi në të gjithë territorin e komunës sonë dhe vazhdimisht bën presion te imamët që këtij burimi jetik t'i kushtojnë rëndësi edhe në ligjëratat e tyre.

V. Marrëdhëniet e KBI-së me organet lokale

Këshilli i BI-së në Vushtrri vazhdimisht ka bërë përpjekje për krijim të marrëdhënieve të mira me organet komunale, qoftë nëpërmjet vizitave të ndërsjella, qoftë nëpërmjet përfaqësimit të Kryetarit të KBI-së Shemsi Rrahimit në komunë për mbledhje, ftesa për manifestime të ndryshme, iniciativa të përbashkëta, etj.

Duke qenë të vetëdijshëm se ajo që kemi bërë në krahasim me atë që duhet bërë për këtë fe madhështore është shumë e vogël, ne lusim Allahu e Madhëruar që për çdo lëshim, gabim a mangësi të na ketë falur, kurse ndihmën për realizimin e synimeve tona në të mirë të komunitetit musliman që përbën shumicën absolute të kësaj komune, të mos na e ndali kurrë. Vërtet, Ai ka mundësi për çdo gjë!

Përshëndetjet qofshin mbi Muhammedin, familjen, shokët dhe pasuesit e tij!

RAPORTON

KRYETARI

(Sedat ISLAMI, sekretar)

(Shemsi Rrahimi, prof.)